

Zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

Kohët e fundit çdo ditë sjell një ngjarje që na heq vëmendjen nga ajo e ditës së kaluar. Tashmë fenomenet negative janë aq të shpeshta sa kanë filluar të mos na bëjnë më përshtypje. E them këtë me keqardhje, sepse e di mjaft mirë që zanafilla e shumë çudirave vjen nga zyra e Kryeministrit tonë. Aq distopik është realiteti që ju keni ndërtuar me tym dhe pasqyra, sa nga njëra anë banorët e fshatrave të Fierit kërkojnë bazën jetësore; ujin, energjinë elektrike, mundësi për t'u punësuar, për të mbajtur frymën gjallë, kurse nga ana tjetër ju flisni për satelitë hapësinorë. Që të nisësh satelitë në hapësirë, minimalisht duhet të kesh një arsim të përsosur. Në universin e ERTV-së nuk ndodh që në shkollën e Shën Pjetrit të qytetit të Fierit klasat e pesta dhe të gjashta ta zhvillojnë së bashku mësimin, por në universin tonë jo vetëm që ndodh, por problemi thellohet edhe më shumë, me një numër të konsiderueshëm shkollash të mbyllura. Në fakt, në rang vendi ne jemi qarku i dytë për mbylljen më të madhe të shkollave, ndërkohë që Fierit ka qenë historikisht një qytet arsimeash. Natyrisht, dramës së përgjithshme të skamjes dhe asaj të arsimit do t'i mbivendosej drama e shëndetësisë. Megjithëse të flasësh për kaosin e shëndetësisë do të duheshin ditë, sot vlen të përmendet që recetat anti-COVID, po rëndojnë çdo ditë e më tepër në xhepat e qytetarëve tanë. Si të mos mjaftonte vaksinimi i detyruar, kjo është një përjasje e gabuar ndaj të rinjve. Në fillim e nxitët ju mosbesimin e qytetarëve ndaj vaksinës, duke sjellë thasë të zinj plehrash mbushur me doza nga një vend anonim, mik, që na donte të mirën. Më pas sollët një koktej vaksinash, ku disa prej tyre nuk ishin aspak efektive dhe nuk ishin të aprovuara nga EMA dhe FDA-ja. Në fund i detyroni të rinjtë të vaksinohen, përndryshe u mohoni të drejtën e shkollimit. Jeni qeveria e mosbesimit. Ktheni pak sytë nga qyteti i Fierit. Vërtet ka fasada të bukura, edhe pse shumë prej tyre u ka dalë boja që vitin e parë. Sa futesh në Fier, ndien erën e lumit Gjanica, e cila vazhdon edhe sot të jetë katastrofë ambientale. Për të mos folur për mbetjet dhe insineratorët. Është po ky qytet, qyteti im, ku shumë biznese të vogla kanë falimentuar, ku shumë të rinj enden rrugëve të papunë dhe ku çdo ditë e më shumë ndihet mungesa e rinisë nëpër qytet. Imagjino pak se çfarë ndodh në zonat rurale. Fermerët e qarkut të Fierit po falimentojnë për shkak të farës së skaduar "OZGAN", që u ble prej tyre pas certifikimit që i bëri Ministria e Bujqësisë para se ta hidhte në treg. Fermeri nuk është skllav që të punojë vetëm për shoqërinë, por duhet të mbajë edhe familjet vet. Dërmenasi, Semani, Darëzeza, Ferma Çlirimi, Povelça e shumë fshatra të tjera kanë probleme serioze me kanalizimet dhe ujërat e zeza. Duket e çuditshme për vitin 2021, por i kemi parë dhe i prekim akoma edhe sot nga afër. Mjafton të shkoni në këto zona dhe menjëherë do ta kuptoni se realiteti i tyre klith mjerim, por ju i qeshni në fytyrë mjerimit. Ju dhe Kryeministri juaj talleni me fermerët, me banorët e zonave rurale, me çdo individ që nuk formatohet për të qenë prerja juaj besnike. Në vitin 2013 qeveria juaj nisi një reformë burgosjesh për armikun më të madh që i kishte zënë sytë këtij populli, hajdutët e mëdhenj, familjet e varfra, që vidhnin energji elektrike për të ndriçuar një dhomë në shtëpitë e tyre, të cilët, nga dëshpërimi se nuk gjenin drejtësi, shkonin deri në varje të vetes. Shumë i burgosi, por krimi i vërtetë është t'u mohosh të drejtat bazë të jetës. Është shkelje e të drejtave të njeriut. Kriza që Kryeministri doli dhe e tha

sikur po prezantonte menynë e darkës, pra si diçka normale, është e paralajmëruar prej shumë kohësh, pasi kambanat e alarmit kanë nisur të bien së bashku me veprimet e papërgjegjshme të qeverive “Rama show” 1, 2 dhe 3. Çfarë u bë me strategjinë e energjisë së rinovueshme? Çfarë u bë me fondet e dedikuara nga Bashkimi European për këto investime? Ku i keni shokët dhe miqtë që i morën këto fonde, zoti Kryeministër? Protesta të shumta janë bërë për të mbrojtur pasuritë hidrike që ne kemi, por, fatkeqësisht, nuk kanë mundur të bëjnë ndryshim, sepse ne jetojmë në një shtet totalitar, ku ajo çfarë populli kërkon është e pavlerë, për sa kohë ke shokë që blejnë çdo votë. Edhe nëse nuk e arrijnë qëllimin, ata nxjerrin armët dhe shkopinjtë e gomës. Çfarë po ndodh me energjinë që këta përbindësja ujëpirës dhe natyrëshkatërrues po prodhojnë? Ka shumë zullume, tenderë dhe PPP. Ka shumë vrasje mafioze. Kaq shumë vuajtje keni shkaktuar në këta 8 vjet e pak qeverisje, sa shpesh mbetem pa fjalë për të shprehur neverinë që ju më shkaktoni. Herët apo vonë çdokush merr atë që meriton, të nderuar. E kam thënë dhe e përsëris për të gjithë: është vetëm çështje kohe. Faleminderit!